



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivered	02-06	2023	3	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKANDSHUK	4580/2023		1/9	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.615/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi -Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.615/2023 të datës 05.04.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat \_\_\_\_\_

me adresë: Rruga \_\_\_\_\_ kundër Vendimit me numër KD.nr.06/2023 i datës 10.03.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe kundër Vendimit KD.nr.051/2022 i datës 08.02.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 02.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.615/2023 e datës 05.04.2023 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër KD.nr.051/2022 i datës 08.02.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës për masën disiplinore "ndalim 20% pages për periudhë dy (2) muaj".
- III. Shfuqizohet Vendimi KD.nr.06/2023 i datës 10.03.2023 i Komisionit Disiplinor dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të datës 14.02.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- IV. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të njëjtit.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

## A r s y e t i m

Ankuesi i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, përmes postës me datë 14.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar me datë 17.03.2023 dhe regjistruar me numër prot:2766/2023, kundër Vendimit me numër KD.nr.051/2022 i datës 08.02.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe po ashtu me datë 05.04.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër prot:3306/2023, kundër Vendimit me numër KD.nr.006/2023 i datës 10.03.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masave disiplinore dhe zhvillimit të procedurës disiplinore ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e aplikuara ligjore të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues, ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material si dhe ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sikurse nuk ka marr për bazë deklaratimet dhe provat e ngritura nga ankuesi në seancën disiplinore, me kërkesën që Këshilli të aprovojë ankesat e ankuesit si të bazuara ndërsa të anulohet Vendimin e datës 10.03.2023 me numër KD.nr.06/2023 të Komisionit Disiplinor dhe Vendimin me numër KD.nr.051/2022 i datës 08.02.2023 të Komisionit Disiplinor.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.03.2023 dhe 14.04.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 18.04.2023 dhe 25.04.2023 ka pranuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës përgjigjen në kërkesa, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Bazuar në kërkesën e Kryetarit të Kolegjit të datës 28.04.2022 për bashkimin e ankesës A.nr.527/2023 të datës 17.03.2023 e parashtruar nga ankuesi dhe ankesa A.nr.615/2023 të datës 05.04.2023 e parashtruar nga ankuesi me datën 28.04.2023 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin me numër VK/2023 me numër protokoll: 3904/2023 përmes të cilit i ka bashkuar ankesat e ankuesit në ankesën e fundit me numër A.nr.615/2023, pasi që baza ligjore dhe parashtrues i ankesës janë të njëjta, ndërsa tani e tutja të dy ankesat do të shqyrtohen në kuadër të lëndës më numër reference A.nr.615/2023.

Po ashtu, Kryetari i Këshillit, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, me datë me 16.05.2022 ka nxjerrë Vendimin VK/2023 më numër prot:4249/2023, përmes të cilit, ankesës së ankuesit ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjes lidhur me këtë çështje ankimore edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.prot:2766/2023 të datës 17.03.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Flet kthesën me shifër evidence:KD.nr.05/22; Vendimi me numër KD.nr.051/2022 i datës 08.02.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimi me numër KD.nr.051/2022 i datës 08.02.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës për shqiptimin e masës disiplinore; Raportin

përfundimtar i hetimeve i datës 09.12.2023 me numër:1303; Ftesën për intervistë të datës 01.12.2022; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 23.11.2023; Deklaratën e bërë nga me datë 23.11.2022; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore 23.11.2022; Ankesën e zyrtarit Kopje e mesazheve telefonike prej shtatë (7) faqesh; Akt emërimit e ankuesit të datës 12.07.2022 me shifër .nr.065/2022; Zarin postar me shifër: R2777441; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.03.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 18.04.2023; Shkresën e Njesisë së Burimeve Njerëzore të datës 14.04.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën “ Zëvendës Drejtor në QP Gjilan”; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 19.01.2020; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 20.01.2022; Vendimi me numër KD.nr.051/2022 i datës 20.12.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; E-mailin e datës 05.07.2022 dërguar nga për ankuesin; E-mailin e datës 24.01.2022 dërguar nga për Vendimin për themelimin e komisionit për vetë monitorim i datës 12.01.22; E-mailin e datës 08.11.2019 dërguar nga për ankuesin; Raportin me shifër evidence Forma.1.1.2; E-mailin e datës 15.11.2019 dërguar nga për ankuesin; E-mailin e datës 28.10.2022 dërguar nga ankuesi për Procesverbalin e seancës së datës 08.12.2022; E-mailin e datës 15.11.2021 dërguar nga për ankuesin; Raportin e datës 10.11.2021 me raportin e bashkangjitur të datës 09.11.2021; Deklaratën zyrtarit E-mailin e datës 01.12.2022 dërguar nga për ankuesin; E-mailin e datës 12.04.2023 dërguar nga për E-mailin e datës 14.02.2023 dërguar nga për ankuesin; Ankesën me Nr.prot:3306/2023 të datës 05.04.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 30.03.2023; Vendimi i datës 25.10.2022; Procesverbalin e seancës së datës 28.02.2023; Fletë kthesën e datës 10.03.2023; Vendimi me numër KD.nr.06/2023 i datës 10.03.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Përshkrimi detyrave të punës për pozitën Zëvendës Drejtor i QP Prizren; Vendimi me numër KD/054/13/12/2022 i datës 13.12.2022 i Komisionit Disiplinor; Vendimi me numër KD.nr.054/2022 i datës 23.01.2023 i Komisionit Disiplinor; Vendimin e datës 26.01.2023 nr.:120 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Shërbimit të Përgjithshëm Korrektues të Kosovës; Fletë kthesën me shifër KD.nr.06/23; Vendimin e datës 13.03.2023 të kryesuesit të Komisionit Disiplinor; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.04.2023; Përgjigjen në kërkesë e datës 25.04.2023; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 14.02.2023; Përgjigjen e ankuesit të datës 08.02.2023 lidhur me raportin hetimor të QPGJ; Njoftimin e ankuesit i datës 20.10.2022; E-mailin e datës 20.10.2022 dërguar nga ankuesi për me korrespondencën e bashkangjitur prej tre faqesh ; E-mailin e datës 20.10.2022 dërguar nga për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej dy faqesh; Ftesën për intervistë të datës 23.02.2023; Procesverbalin e seancës së datës 28.02.2023; Fletë kthesën e datës 15.03.2023; Fletë kthesën e datës 10.03.2023; Vendimin e datës 23.08.2021 të Drejtorit të QP Gjilan; Procesverbali i intervistimit i datës 08.11.2022 për zyrtarin Procesverbali i intervistimit i datës 08.11.2022 për zyrtarin Procesverbali i intervistimit i datës 08.11.2022 për zyrtarin Procesverbali i intervistimit i datës 08.11.2022 për zyrtarin Procesverbali i intervistimit i datës 08.11.2022 për zyrtarin Lista e regjistrimet të sjelljeve të burgosurit Dosja e të burgosurit e datës 24.09.2022 me shkresat e bashkangjitura; Lista e regjistrimet të sjelljeve të burgosurit për datat 02.11.2022-03.11.2023 dhe 05.11.2022; Lista e regjistrimet të sjelljeve të burgosurit për datat 19.10.2022; Dosja e të burgosurit B.Rr e datës 17.08.2022 me shkresat e bashkangjitura; Dosja e të burgosurit e datës 07.08.2022 me shkresat e bashkangjitura; Dosja e të burgosurit e datës 20.07.2022 me shkresat e bashkangjitura; Dosja e të burgosurit e datës 21.09.2022 me shkresat e bashkangjitura; Shkresën e datës 12.10.2022 lëshuar nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve;

Lista e regjistrimi të vëzhgimit për të burgosurin [ ] e datës 26.10.2022, 03.11.2022; 04.11.2022 dhe datës 07.11.2022; Dosja e të burgosurit [ ] e datës 29.09.2022 me shkresat e bashkangjitura; Shkresën e datës 29.09.2022 lëshuar nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve; Lista e regjistrimi të vëzhgimit për të burgosurin [ ] të datës 03.11.2022, 25.10.2022, 07.11.2022, Dosja e të burgosurit [ ] e datës 18.10.2022 me shkresat e bashkangjitura; Shkresën e datës 18.10.2022 lëshuar nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve; Lista e regjistrimi të vëzhgimit për të burgosurin [ ] e datës 21.10.2022, 23.11.2023, Vendimin e datës 20.10.2022 lëshuar nga Mbikëqyrësi i Lart [ ] Shkresën e datës 10.10.2022; Vendimin e datës 20.10.2022 lëshuar nga Mbikëqyrësi i Lart [ ] për [ ] me raporto e bashkangjitur të datës 20.10.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa A.nr.615/2023 e datës 05.04.2023 e parashtruar nga ankuesi [ ] është e **bazuar**, sepse:

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi [ ] sipas Aktit të Emërimit AE.Nr.065/2022 të datës 12.07.2022 ka të themeluar marrëdhënien e punës pranë Shërbimit Korrektues të Kosovës në pozitën "Zëvendës Drejtor i Qendrës së Paraburgimit-Qendra e Paraburgimit Gjilan", ndërsa ndaj të njëjtit me datë 23.11.2022 udhëheqësi i drejtpërdrejtë, gjegjësisht Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan ka kërkuar nga Komisioni Disiplinor inicimin e procedurës disiplinore për shkak të dyshimit se ankuesi ka kryer shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 dhe 3.8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 58 paragrafi 1 dhe 3, pika 3.10 i Ligjit për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Komisioni Disiplinor sipas shkresave të lëndës konstatohet se ka mbajtur seancën e disiplinore me datë 08.12.2022, mirëpo me datë 20.12.2022 Komisionin Disiplinor kishte nxjerrë vendimin KD-051/2022 përmes të cilit e kishte pezulluar procedurën e iniciuar disiplinore duke iu referuar nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me arsyetimin se ndaj ankuesit është hapur një rast tjetër i inicimit të procedurës disiplinore me datë 13.12.2022 nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues dhe se ankuesi është pezulluar përkohësisht nga puna, prandaj lënda pezullohet deri në zgjidhjen e çështjes paraprake.

Tutje, Komisioni Disiplinor me datë 08.02.2023 nxjerr Vendimin KD.nr.051/2022 përmes të cilit e shfuqizon Vendimin KD-051/2022 e datës 20.12.2022 mbi pezullimin e përkohshme të procedurës disiplinore dhe e aktivizon procedurën e iniciuar disiplinore ndaj ankuesit nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë, ndërsa po në të njëjtën ditë Komisioni Disiplinor nxjerr Vendimin KD.nr.051/2022 të datës 08.02.2023 përmes të cilit ankuesit i shqiptohet masa disiplinore "ndalim 20% pagës për periudhë dy (2) muaj" me arsyetimin se ankuesi është gjetur përgjegjës për shkelje të 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 dhe 3.8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 58 paragrafi 1 dhe 3, pika 3,10 i Ligjit për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Kolegji i Këshilli gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit ka ardhur në përfundimin se Komisionin Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit KD.nr.051/2022 të datës 08.02.2023 përmes të cilit e shfuqizon Vendimin KD-051/2022 e datës 20.12.2022 mbi pezullimin e përkohshëm të procedurës disiplinore, ndërsa e aktivizon procedurën e iniciuar disiplinore ndaj ankuesit dhe po në të njëjtën ditë Komisioni Disiplinor nxjerr vendimin KD.nr.051/2022 të datës 08.02.2023 përmes të cilit ankuesit i shqiptohet masa disiplinore "ndalim 20% pagës për periudhë dy (2) muaj", dhe mbi këtë bazë është konstatuar fakti se Komisioni Disiplinor ka vepruar në

kundërshtim me nenin 144 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar”*, ngase Vendimi KD.nr.051/2022 i datës 08.02.2023 për aktivizimin e procedurës disiplinore ka përmbajtur këshillën juridike përmes të cilit ankuesi është udhëzuar se mund të parashtrojë ankesë në KPMSHCK në afat prej 30 ditësh, mirëpo Komisioni Disiplinor në po të njëjtën ditë ka nxjerr vendimin tjetër me shifër KD.nr.051/2022 të datës 08.02.2023 përmes të cilit ankuesit i shqiptohet masa disiplinore *“ndalim 20% pagës për periudhë dy (2) muaj”*, veprime këto të cilat e kanë shpërfillur këshillën juridike prej 30 ditësh ndërlidhur me nenin 144 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Po ashtu nga përmbajtja e Vendimit me shifër KD.nr.051/2022 të datës 08.02.2023 përmes të cilit ankuesit i shqiptohet masa disiplinore *“ndalim 20% pagës për periudhë dy (2) muaj”* si dhe nga shkresat e lëndës të ofruara nga organi i punësimit me datë 14.04.2023, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komisioni Disiplinor ka vepruar në kundërshtim me nenin 12 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku ndër tjerash përcaktohet se: *“Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t’u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit”*, ngase në seancën disiplinore nuk është ftuar edhe iniciuesi i procedurës disiplinore, sikurse Komisioni Disiplinor është dashur të ftojë në cilësi të dëshmitarit edhe zyrtarin \_\_\_\_\_ i cili përmes ankesës kishte kërkuar nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit të ndërmarrë veprime lidhur me sjelljet e ankuesit \_\_\_\_\_ sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 12 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.4 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku ndër tjerash përcaktohet se: *“Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: 3.1. Merr në pyetje ose merr deklaratat, 3.4 Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes”*.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka gjetur se në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 23.11.2022 udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit potencon se ankuesi, *citoj: “... sepse në vazhdimësi gati qe 2 (dy) vjet dhe së fundmi me datë 28.10.2022 gjatë orarit të punës dhe pas orarit të punës në vazhdimësi bënë presion duke kërcënuar dhe përdorë fjalë denigruese etj, ..ndaj zyrtarit \_\_\_\_\_”* sikurse edhe zyrtari \_\_\_\_\_ në ankesën e tij kundër ankuesit shprehet se ankuesi \_\_\_\_\_ me datë 28.10.2022 e kishte kërcënuar duke përdorur fjalë denigruese, ndërsa lidhur me këto të gjetura Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 46 paragrafi 4 të Ligjit Nr.04/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar”* dhe mbi këtë bazë konstatohet fakti se natyra e shkeljes së pretenduar nga ankuesi hynë në kuadër të shkeljeve të lehta disiplinore sikurse përcaktohet me nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.3 dhe 4.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, nga rrjedh se Komisioni Disiplinor nuk ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike duke vepruar kështu jashtë mandatit të tij ligjor sikurse përcaktohet me nenin 48 paragrafi 1 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ndërlidhur me nenin 13 paragrafi 2 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku ndër tjerash përcaktohet se: *“Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt shqipton masën disiplinore të përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit për shkeljet e përcaktuara me nenin 46 paragrafi 4 të Ligjit”* prandaj nisur nga të gjeturat e konstatuara Kolegji i Këshillit

konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar për shkak të shkeljeve procedurale dhe interpretim të gabuar të ligjit material nga Komisioni Disiplinor dhe mbi këtë bazë Vendimi KD.nr.051/2022 të datës 08.02.2023 përmes të cilit ankuesit i shqiptohet masa disiplinore “ndalim 20% pagës për periudhë dy (2) muaj”, është akt administrativ i kundërligjshëm sikurse përcaktohet me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe i njëjti është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit, po ashtu ka gjetur se Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, me datë 14.02.2023 ka kërkuar nga Komisioni Disiplinor inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit për shkak të dyshimit se ankuesi ka kryer shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe nenit 48 paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, ndërsa kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës e mbështet në Raportin Përfundimtar të Hetimeve me numër:1303 të datës 09.12.2022 i hartuar nga Komisioni Hetimor, sikurse përcaktohet tek pjesa e rekomandimit në pikën dhjetë (10), citoj: “Komisioni hetimor rekomandon Zëvendësuesin e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, të marr masa disiplinore ndaj vartësve të tij..., Zv. Drejtorit të Q.P Gjilan në bazë të nenit 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publik.”.

Tutje, Kolegji i Këshillit nga shkresat e lëndës ka gjetur se ankuesi me datë 24.02.2023 përmes emailit zyrtar është ftuar që të marrë pjesë në seancën disiplinor të paraparë të mbahet me datë 28.02.2023 në prani të Komisionit Disiplinor lidhur me shkeljen e supozuar disiplinore, ndërsa nga procesverbali i datës 28.02.2023 si dhe përmbajtja e Vendimit me numër KD.nr.06/2023 i datës 10.03.2023 të Komisionit Disiplinor konstatohet fakti se në seancë disiplinore është ftuar vetëm ankuesi.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 12 paragrafi 3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrarëve Publikë ku shprehimisht rregullohet se: “1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura; 3. Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: 3.1. Merr në pyetje ose merr deklarata nga dëshmitarët dhe verifikon faktet; 3.2. Rishikon dokumentacionin përkatës; 3.3. Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t’u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit; 3.4. Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes” si dhe dispozitat e nenit 46 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë ku përcaktohet se: “Procedura administrative disiplinore garanton të drejtën e nëpunësit për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, të drejtën për të pasur qasje në dokumente që lidhen me procedurën, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t’u asistuar, si dhe të drejtën për t’u ankuar ndaj vendimit përfundimtar. Nëpunësi civil mund të ndihmohet gjatë procedurave disiplinore nga një përfaqësues i sindikatës ku bën pjesë, nga një avokat apo nga një përfaqësues i nëpunësve civilë të institucionit, nëse nuk është anëtar i një sindikate”, nga rrjedh se ankuesi nuk është njoftuar paraprakisht për natyrën e shkeljes dhe rrethanat e veprimit apo mos veprimit për të cilat dyshohet, sikurse i njëjti nuk është njoftuar se ka të drejtë të jetë i shoqëruar me avokat apo me përfaqësues të sindikatës, gjegjësisht Komisioni Disiplinor me rastin e mos ftesës së iniciuesit të procedurës disiplinore dhe të dëshmitarëve apo të rishikimit të dokumentacionit të administruar nga anëtarët e Komisionit Hetimor ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 11 paragrafi

1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 12 paragrafi 3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Tutje, Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit i është referuar ekzistimit të masave të tjera disiplinore të shqiptuara ndaj ankuesit dhe të njëjtat i ka përdorur me qëllim të shqiptimit të masës disiplinore, prandaj me këtë rast Komisioni Disiplinor është dashur ta kuptojë drejtë përcaktimin ligjor në nenin 50 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet *“Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji”*, ngase sipas nenit 51 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik është përcaktuar edhe afati kohor i shuarjes së masave disiplinore, nga rrjedh se Komisionin Disiplinor nuk është lëshuar fare në këtë pjesë të konstatimit e në fakt iu është referuar dy masave disiplinore sipas vendimit të datës 13.01.2017 dhe atij të datës 18.12.2019, pa konstatuar faktin nëse të njëjtat janë aktive apo janë shuar sipas përcaktimeve ligjore.

Komisioni Disiplinor, po ashtu i është referuar edhe Vendimit Nr.051 të datës 08.02.2023 të Komisionit Disiplinor përmes të cilit akt, ankuesit i është shqiptuar masë disiplinore për shkelje të rënda disiplinore, mirëpo ka harruar faktin se ky akt ka mundur të prodhojë efekte juridike për ankuesin vetëm pasi të plotësohen parakushtet ligjore në kuptim të nenit 144 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar”* e për rrjedhojë ndaj të njëjti akt ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshill me datë 17.03.2022 e regjistruar me shifër A.nr.527/2023 e cila është bashkuar me ankesën A.nr.615/2023, andaj në kuptim edhe të nenin 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën”* nga rrjedh se në rastin konkret Komisioni Disiplinor nuk ka mundur t'i referohet kësaj mase si masë rënduese apo veprim i përsëritur, sepse e njëjta s'ka hyrë në fuqi, madje ky akt administrativ është shfuqizuar përmes këtij vendimi sikurse në diapozitivin e këtij vendimi.

Prandaj nga se u tha si më lartë, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, analizimit të dispozitave ligjore dhe konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se me rastin e shqiptimit të masës disiplinore *“Largim nga Shërbimi Civil”* ndaj ankuesit përmes Vendimit me numër KD.nr.06/2023 të datës 10.03.2023, Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, procedurën administrative e ka zhvilluar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative të konstatuara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, prandaj në mbështetje të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme”*, Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi me numër KD.nr.06/2023 i datës 10.03.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës është akt administrativ i kundërligjshëm për shkak të shkeljeve procedurale, prandaj i njëjti është

shfuqizuar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa lënda e ankuesit ndërlidhur me procedurën e iniciuar disiplinore sipas kërkesës së datës 14.02.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni Disiplinor, pasi që Kolegji i Këshillit për shkak të lëshimeve procedurale nga Komisioni Disiplinor të përcaktuara si më lartë, nuk ka mundur të konstatoje saktë gjendjen faktike nëse ankuesi ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Kolegji i Këshillit, thekson faktin se Komisioni Disiplinor me rastin e rishqyrtimit dhe rivendosjes të procedurës së disiplinore ndaj ankuesit të iniciuar sipas kërkesës së datës 14.02.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, duhet të marrë përbazë pikëpamjet juridike të dhëna në arsyetimit këtij vendimit, duke konstatuar dhe vlerësuar drejtë të gjeturat e Komisionit Hetimor të datës 09.12.2023, duke i ftuar anëtarët e të njëjtit komisionin në seancë për tu njohur me variantin e tyre të ngjarjes, dhe po ashtu duhet të shqyrtojë pretendimin e ankuesit lidhur me njoftimin e datës 20.10.2022 të përgatitur nga ankuesi për udhëheqësin e tij të drejtpërdrejt si dhe e-maili i datës 20.10.2022 përcjellë nga ankuesi për Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës përmes të cilave shkresa ankuesi synon se ka vepruar në funksion të përmbushjes së detyrave funksionale të punës, gjegjësisht nëse veprimet e tilla kanë qenë në funksion të marrjes së masave për parandalimin e krijimit të rrethanave apo ndodhive që bien ndesh me aktet e brendshme rregullative, sikurse përcaktohet me nenin 50 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë: *"1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit."*, nga rrjedh se Komisioni Disiplinor duhet të analizojë dhe shqyrtojë çdo rrethanë apo dokumentacion tjetër me qëllim të konstatimit të saktë të gjendjes faktike dhe vendosjes meritore.

Nga se u tha si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit e ka aprovuar pjesërisht ankesën ankuesit duke e shfuqizuar Vendimi me numër KD.nr.051/2022 i datës 08.02.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës lidhur me shqiptimin e masës disiplinore, *"ndalim i 20% pagës për periudhë dy (2) muaj"*, ndërsa lidhur me pretendimet e ankuesit që ndërlidhen me shqiptimin e masës disiplinore *"Largim nga Shërbimi Civil"* Kolegji i Këshillit nuk ka vendosur meritorisht mirëpo Vendimin KD.nr.06/2023 e datës 10.03.2023 të Komisionit Disiplinor e ka shfuqizuar ndërsa lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje për shkak të shkeljeve procedurale nga ana e Komisionit Disiplinor.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe paragrafi 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 4 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.615/2023

**Flakron GASHI**

*Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional*



**Eshref SHABANI**

*Kryetar i Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesit, avokat
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së